

S T A T U T
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

"TECTRUM" Sh.p.k

KAPITULLI I
EMRI, FORMA, BAZA JURIDIKE, SELIA, TERRITORI

Neni 1
Emri

Shoqëria tregtare me përgjegjësi të kufizuar **"TECTRUM" Sh.p.k**, e cila më poshtëdo të quhet "Shoqëria", është themeluar nga ortakut i vetëm z.Eris LIKA,. lindur më 03.04.1982 në Korcë me Shtetësi dhe kombësi shqipëtar, identifikuar me letërnjoftimin e tij më numër personal I20403233T Në përputhje me vullnetin e tij të lirë dhe mbështetur në Ligjin me Nr. 9901. datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe me Ligjin me Nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit" themeluesi i shoqërisë dhe Ortaku i vetëm i saj, Eris LIKA miratoi sot më datë 02.11.2020 dhe nënshkruan edhe këtë status të shoqërisë **"TECTRUM" Sh.p.k**.

Neni 2
Forma


Kjo Shoqëri është një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar. Themeluesit e saj janë persona fizik që mbulojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara dhe nuk përgjigjet për humbjet e shoqërisë tregtare.

Neni 3
Baza juridike

Shoqëria është krijuar në bazë të legjislacionit të Republikës së Shqipërisë, dhe konkretisht në bazë të Ligjit me Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe të Ligjit me Nr. 9723. date 03.05.200 të ndryshuar", Per Qëndrën Kombetare te Rregjistrimit" dhe, si person juridik, e zhvillon aktivitetin në përputhje me këtë legjislacion dhe me normat e këtij Statuti. Ajo ka personalitet juridik dhe është e regjistruar në Qendren Kombetare të Rregjistrimit (QKR).

Neni 4
Selia

Selia e Shoqërisë është në Tiranë në adresën: **Shqiperi, Tirane, Sauk, Pallati L, Hyrja 5, Apartamenti 10, Zona Kadastrale Nr.3266, Numër Pasurie 102/21 + 5-10** . Shoqëria mund të ndryshoje selinë e saj me vendim te Ortakeve. Shoqëria do të konsiderojë selinë e percaktuar



me siper si Shoqeria Mëmë, e cila rast pas rasti mund te hapë degë, filiale ose degë te perbashkëta në të gjitha ato vende ku do të shikojëinteres në përmbushjen e qëllimit të saj.

Neni 5 Territori

Shoqëria e zhvillon aktivitetin si ne territorin e Republikës së Shqipërise ashtu edhe jashtë saj.

KAPITULLI II OBJEKTI DHE KOHËZGJATJA E SHOQËRISË

Neni 6 Objekti

Shoqëria ka si objekt të veprimtarisë së saj fushen e ndërtimit. Ne fushen e ndertimi shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te veprave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi, publike dhe/ose private si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugeve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, autostradave, traseve hekurudhore, dhe te gjitha veprave te tjera madhore, ujesjellesave, Ujrave mbitokesore dhe nentokesore per energjine dhe telekomunikacionet, ndertimin dhe rehabilitimin e veprave ujitesore, centralet, objektet turistike, objektet ushtarake, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, portet, aeroportet, objektet industriale, te gjitha restaurimet ne pergjithesi, rikonstruksione te veprave te artit, montimet e konstruksioneve metalike; si dhe cdo ndertim tjetër i cili ne perfundim perben send te paluajtshem sipas Kodit Civil per shkak te trupezimit ne menyre te qendrueshme e te vazhdueshme me token ose ndertesën ku eshte vendosur. Ne fushen e minierave shoqeria do te kryeje: Studimin, zbutimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te minierave me karakter shfrytezimi dhe/ose administrimi public dhe/ose privat si: ndertimin dhe shfrytezimin e minierave publike dhe private per te tera llojet e mineraleve, shfrytezimin e burimeve natyrore te ujrave minerale dhe termale; nxjerja, prodhimi, perpunimi dhe tregtimi brenda vendit e mineraleve te paperpunuara dhe te perpunuara. Ne fushen e turizmit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te infrastruktures dhe/ose te pjeseve perberese te saj, per shfrytezimin njerezor me karakter pushues, argetues, edukues dhe/ose kurues, te burimeve natyrore, kulturore, mjedisore kurative, te Shqiperise dhe me gjere, perrealizimin e hotelerise, fshate turistike, qendra turistike e te tjera dhe krijimin e fasiliteve dhe aksesoreve te nevojshem, si bar bufe-restorante, qendra estetike, palestra fitnesi, njesite shitjeve te konfeksioneve dhe prodhimeve ushqimore e industriale e te tjera te kesaj natyre; Krijimin e agjencive turistike e te tjera. Ne fushen e transportit, shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen, sipermarrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te infrastruktures dhe/ose te pjeseve perberese te saj, per transportimin publik dhe/ose privat te njerezve dhe mallrave si dhe tranzitimin e tyrepergjate territorit te Shqiperise nepermjet transportit rrugor, hekurudhor, ajror, ujor, teleferik etj. Shoqeria gjithashtu do te kryeje dhe duke mos u kufizuar vetem ne, aktivitetet emeposhtme: - Ngarkim dhe shkarkim te anijeve; Pritje dhe levrim te ngarkesave nga dhe per ne anije; Stivim, depozitim, transportim, etiketim, ambalazhim, lidhje, numerim, pritje, perpunim, dhe levrim i



ngarkesave nga dhe neper anije.- Siper marrje dhe realizimi i cfaredolloj aktiviteti te ligjshem lidhur dhe ne sherbim te ngarkimit dhe shkarkimit te anijeve
ne cdo vendankorim, ne porte. - Siper marrje, per gatitje dhe realizim i procesit te ngarkimit dhe te shkarkimit te konteniereve, te mjeteve te tjera transportuese, te anijeve, ne interes dhe per llogari te pronarit te anijes, pergjithesisht te mjetit transportues, ne interes dhe per llogari te pronarit te
ngarkeses dhe/ose te porositesit te automjeteve/ trenit, anijes apo porositesve te tjere te ligjshem.- Siper marrje dhe realizim i ndermjetesimit dhe transportit, ngarkimit dhe shkarkimit te mallrave me tren e automjete ne interes dhe per llogari te shoqerise dhe te Porositesve, persona te trete.- Ngarkim dhe shkarkim i trenave;Pritje dhe levrime i ngarkesave nga dhe per ne stacionet e destinuar;Stivim,depozitim, transportim, etiketim, ambalazhim, lidhje, numerim, pritje, perpunim dhe levrime I ngarkesave nga dhe per transport hekurudhor dhe tokesor;Siper marrje dhe realizimi i puneve te ndermjetesimit, agjencise dhe transportit ne interes te vete shoqerise ose te paleve te tretave porositesve.Ne fushen e mjedisit shoqeria do te kryeje: Studimin, projektimin, konsulencen,siper marrjen zbatuese dhe/ose investimin, sipas rastit, per realizimin me fonde publike dhe/ose jopublike te mbrojtjes dhe ose permirosimit si dhe rehabilitimit te kushteve te mjedisit rrethues; perpunimin e mbetjeve urbane, toksike, radioaktive, teknologjike si dhe mbetje te cdo lloji tjetere, trajtimi i ujrave industriale, projektimin,mbikqyrjen ne fushen e kerkimit dhe shfrytezimit te lendes drusore, trajtimin dhe mbrojtjen e pyjeve, riaftesimin dhe trajtimin e tokave te kripura e kenetave si dhe cdo veprimtari qe ka rendesi per shoqerine.

Neni 7 Kohëzgjatja

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një afat të pakufizuar. Duke filluar nga data e regjistrimit në QKB, me përjashtim të rastit të mbarimit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj, në statut ose me vendim të Ortakëve.

KAPITULLI III AUTORITETI I ORTAKUT, LIBRI I SHOQËRISË, KOFIDENCIALITETI

Neni 8 Autoriteti i Ortakut

Autoriteti i ortakut dhe përqindja e fitimeve ose humbjeve do të kenë si kriter bazë kapitalin e shoqërisë. Si dhe kompetencat qe ka ortakut në marrjen e vendimeve të çdo natyre, të përcaktuara në këtë statut dhe ligjin per “Tregtarët dhe shoqëritë tregtare”

Neni 9 Libri i Shoqërisë

Për te mbajtur veprimtarinë e saj ekonomike si dhe marrëdhëniet e punës, shoqëria do të hapë librin e saj, i cili do të quhet Libri i Shoqërisë.



Neni 10 Kofidencialiteti

Personat e pranuar në shoqëri, duhet që mos ekspozojë asnjë personi të jashtëm informacionet që do të disponojë shoqëria, kontratat që mund të lidhë, apo cdo lloj materiali, si dhe planifikimet dhe qëllimet e shoqërise.

Neni 11 Dokumentat e destinuara për të tretët

Të gjitha aktet dhe dokumentat që dalin nga Shoqëria dhe kanë destinacion të tretët, si letrat, faturat, njoftimet...etj, duhet të tregojnë lexueshëm emrin e Shoqërisë dhe pas emrit fjalët "Shoqëri me përgjegjësi të Kufizuar", ose inicialet Sh.P.K, si dhe emrin e administratorit.

KAPITULLI IV KUOTAT DHE KALIMI I KUOTAVE TË SHOQËRISË

Neni 12 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërise është 100,000 lekë (njqindmije lekë) Shoqëria mund ta shtojë ose zvogëloje kapitalin, në varesi të nevojave dhe rezultateve të saj me vendim të ortakëve.

Neni 13 Kuotat

Kapitali themeltar është i përbërë nga 1 (një) kuotë e barabartë me numrin total te aksionerëve (100%).

Neni 14 Zotërimi I kuotave

Kuotat e shoqërisë zotërohen 100% nga Eris LIKA në vlerën e 1 (një) kuote.

Neni 15 Mënyrat e fitimit dhe të kalimit të kuotave

Kuotat e shoqërisë janë fituara nga ortaku me kontributin e tij financiar në kapitalin e shoqërisë. Kuotat e shoqërisë mund të kalojnë lirisht tek personat e tretë me shitblerje me miratimin e ortakëve të shoqërisë. Gjithashtu kuotat e shoqërisëmund te kalojnë me rrugë trashgimie. Bashkëshortja, pasardhësit mund të bëhen ortak nëpërmjet kalimit të kuotave me vendim të ortakëve dhe sipas kushteve që lejohen në ligj. Kalimi i kuotave të shoqërisë me shitblerje bëhet me kontratë me shkrim dhe të vërtetuar me akt noterial.



KAPITULLI V STRUKTURA, ORGANET DREJTUESE DHE ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 16 Organet Drejtuese

Organet drejtuese të shoqërisë janë Ortakët e shoqërisë dhe Administratori.

Neni 17 Kompetencat e Ortakëve

Kompetencat e Ortakëve do të jenë:

- Përcakton politikat tregëtare të shoqërisë
- Vendos për ndryshimet në Statutin e Shoqërisë, kalimin e kuotave, zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë
- Emëron dhe shkarkon administratorin e Shoqërisë
- Mbikëqyrjen e politikave tregëtare nga administratori
- Emërimin dhe shkarkimin e likuidatorëve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar
- Perfaqësimin e shoqërisë në gjykata dhe në procedurat e tjera ndaj administrative
- Vendos për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- Shqyrton bilancin vjetor, përcakton llojet e fondeve të ndryshme dhe masën e tyre, fitimin e realizuar si dhe vendos për ndarjen e dividendëve.
- Vendos krijimin e filialeve ose të perfaqësive si dhe për krijimin e shoqërive me persona të tjerë fizikë apo juridikë.

Neni 18 Vendim-marrja e Ortakëve

Administratori ose eksperti konabel të autorizuar, dhe nëse ka të tillë, ose likuiduesi mund të propozojnë dhe të kërkojnë shqyrtimin e çështjeve të ndryshme nga ortakët e shoqërisë. Njoftimi bëhet me shkresë ose përmes postes elekuonike ku pershkruhet ceshtja dhe propozimi konkret.

Neni 19 Administratori dhe kompetencat e tij

Shoqëria do të ketë një administrator të cilet emërohet nga Ortakët. Administratori i shoqërisë është **z.Eris LIKA**.

Kompetencat e administratorit në mënyrë konkrete dhe të detajuara përcaktohen në aktin e emërimit.

Administratori në rast kur nuk është Ortaku i vetëm i Shoqërisë përveç të tjerave ka të drejtë dhe detyrohet të:

- Të administrojë veprimtarinë tregëtare të shoqërisë duke zbatuar politikat tregëtare të vendosura nga Ortakët.
- Të kujdeset për mbajtjen e saktë dhe të rregullt të dokumentave dhe librave kontabël.



- Të përgatisë dhe të nënshkruajë bilancin vjetor të shoqërisë, bilancin e konsoliduar dhe propozon shpërndarjen e fitimeve duke kërkuar për këto miratimin e asamblesë së përgjithshme.
- Të rregjistrojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë ne QKB.
- Të raportojë përpara ortakëve për realizimin e politikave tregtare të shoqërisë.
- Të koordinojë veprimtarinë e personave të punësuar ne shoqëri.
- Të përfaqësojë shoqërinë në marrëdhënie me organet shtetërore dhe me personat e tretë.

Emërimi i administratorëve do te behet për nje afat 5 vjecar me të drejtë riemërimi. Administratorët janë përgjegjës ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve qoftë për shkelje ligjore, qoftë për shkelje të statutit.

Emërimi dhe shkarkimi i administratorëve behet me vendim të ortakëve të shoqërisë.

KAPITULLI VI LIBRAT E SHOQËRISË, BILANCI, DIVIDENTËT

Neni 20 Librat e Shoqërisë

Shoqeria eshte e detyruar te mbaje, pervec Librit te Shoqerise ne te cilin shenohet emri i plote i ortkeve nese ne te ardhmen do te kete me shume se nje ortak dhe kapitalin themeltar, si dhe vendimet e ortakeve ose te asamblese se ortakeve nese do te kete me shume se nje ortak, edhe dokumentacionin kontabel dhe librat e tjere.

Neni 21 Bilanci

Bilanci mbvillet ne 31 dhjetor te cdo viti. Llogaritet vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar, raportet e hartuara nga ekspertit kontabel i autorizuar. Propozimet per ndarjen e fitimeve nenshkruhen nga administratori dhe miratohen nga Ortaket e Shoqerise.

Miratimi i dokumentave mbi veprimtarine vjetore behet brenda nje afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes se vitit financiar.

Neni 22 Dividentët

Oraket e shoqerise miratojne llogarite vjetore dhe evidenton ekzistencen e fitimit, percakton fitimin e vitit financiar te cilit pasi i jane zbritur shumat e lena menjane per rezerven sipas ligjit ose te percaktuar nga vete Ortaket. fondet e tjera qe shihen te nevojshme dhe pasi jane zbritur ose shtuar respektivisht humbjetapo fitimet e mbartura nga vitet e meparshme percakton dhe dividendin. Ortaket vendosin dhe per ndarjen e dividendit.

Neni 23 Marrëdhëniet e Punës

Marredheniet e punes ne shoqeri gjejne rregullim ne kontraten e punes,ne Kodin e Punes dhe ne aktet e tjera qe kane dale ne zbatim te ketij kodi.



KAPITULLI VII LIKUJDIMI DHE PRISHJA E SHOQËRISË

Neni 24 Mbarimi

Shoqeria priset:

- me vendim te Ortakeve
- me hapjen e procedurave te falimentimit
- nese nuk ka kryer veprimiari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise se saj ne Qendren Kombetare te Biznesit (QKB)
- me vendim te gjykates

Ne te gjitha rastet Ortaku i Shoqerise duhet te regjistroje prishjen e shoqerise ne QKR ne perputhje me nenet 43 dhe 45 te ligjit me Nr. 9723. date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Rregjistrimit", te ndryshuar.

Neni 25 Likujdimi i shoqërisë

Prishja e shoqerise ne gjendjen e aftesise paguese behet me proceduren e likujdimit te shoqerise kur nuk eshte nisur procedure falimentimi.

Ky fakt rregjistrohet ne QKR, duke shtuar tek emri i shoqerise shenimin ne "likujdim"

Per te ndjekur proceduren e likujdimit Ortaket emerohet nje likujdues.

Nese shoqeria priset me vendim gjykate, likujduesi emerohet nga Gjykata.

Shkarkimi i likujduesit behet me te njejten menyre sic behet dhe emerimi i tyre .

Ne rast prishje shoqeria do te perpiqet te aplikojte likuidimin e thjeshtezuar ne perputhje me dispoziten e neneve 204 dhe 206 te Ligjit me Nr. 9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", te ndryshuar.

KAPITULLI VIII MOSMARRËVESHJET DHE DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 26 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Te gjitha mosmarrveshjet qe mund te lindin gjate ekzistences se shoqerise ose gjate periudhes se likuidimit ortaku i vetem dhe administratori do te perpiqen ti zgjidhin me mirekuptim dhe nese kjo nuk arrihet, do t'i paraqitet per zgjidhje Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane, seksioni tregtar.



Neni 26
Dispozita të fundit

Pasuria e Shoqërisë mund të sigurohet në ndonjë Institut Sigurimi si brenda ashtu edhe jashtë Shqipërisë.

Shoqëria do të ketë vullnet të saj. Forma dhe madhësia e së cilës përcaktohen nga Ortaket.

Ky Statut është hartuar në 3 (tre) ekzemplare në gjuhën shqipe duke patur secili ekzemplar fuqi të njëjtte ligjore.

ORTAKËT E SHOQËRISË

Eris LIKA

